



## Departamenti i Prokurimit

Prishtina: datë, 16.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 13.11.2022 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Dielli Construction", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe rregullimi i vendeve të kontinjerëve", me Nr. të Prok: 616 22 122 111

### V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të "Dielli Construction" të dt. 13.11.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit "616 22 122 111", kundër [Njoftimit për dhënie të Kontratës] të AK –së, të datës 09.11.2022 të publikuar në web-faqe të KRPP-së .
2. Aprovohet vendimi i AK për [dhënien e kontratës] të publikuar me datë: 09.11.2022
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim nga OE "Dielli Construction", AK ju sqaron se pretendimet tua janë të paqëndrueshme. Pretendimi se AK është dashur të kërkojë sqarime duke u mbështetur në LPP në nenin 72 është i paqëndrueshëm për faktin që për një kriter të tillë nuk mund të kërkojë sqarime.

**Ne LPP dhe ne Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik te Shembujt e mëposhtëm nuk janë të paraqitura rastet se si AK duhet të veproj ne përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se**

**Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese eDT**

**Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm 57**


Bazuar ne këtë, oferta juaj është e papërgjegjshëm dhe si e tille nuk ka pas mundësi te vazhdohet me tutje.

AK duke u mbështetur ne Parimet e përgjithshme te LPP , përkatësisht ne nenin 7 Barazia ne trajtim / jo diskriminim qe thotë se AK do ti trajtoj operatoret ekonomik ne mënyrë te barabarte jo diskriminuese dhe ne mënyrë transparente, ka bere vlerësimin e ofertave dhe ka marr një vendim te tillë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit